



## PROCESVERBALI

Nga mbledhja e gjashtë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 26.06.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi në ora 10:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje janë të pranishëm 13 nga 18 asamblistë dhe se ka kuorum, ndërsa mungojnë 5 asamblistë: Sonja Odalloviq, Dragan Maksimoviq, Millosh Dimiq, Ljubisha Karaxhiq dhe Nebojsha Markoviq.

Në mbledhje morën pjesë kryetarja e Komunës së Graçanicës, shefja e Kabinetit të kryetares, përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, drejtoret e të gjitha drejtive të komunës, si dhe drejtori i NPK "Ekologja" dhe drejtoresha e OTG-së, mediat, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se është mbajtur mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa para mbledhjes së sotme të Kuvendit si dhe se Komiteti njëzéri e dha mendimin pozitiv për rendin e propozuar të ditës. Kryesuesi e hodhi në miratim rendin e propozuar të ditës.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzéri, me votat e 13 asamblistëve "Pro", miratoi rendin e propozuar të ditës.**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e rregullt, e mbajtur më datën 07.06.2024.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komunës së Graçanicës për periudhën prej 01.12.2023 deri më 31.05.2024, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit për periudhën 01.12.2022-01.12.2023, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Dushan Cvejiq.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për fillimin e procedurës së shpronësimit të tokës për zgjerimin e varrezave në Llapllasellë, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Inspepcionit për vitin 2023, me propozim të drejtore të Drejtorisë së Inspepcionit, Marko Arsiq.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e rregullt, e mbajtur më datën 07.06.2024.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 13 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komunës së Graçanicës për periudhën prej 01.12.2023 deri më 31.05.2024, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Raportin e prezantoi kryetarja e Komunës së Graçanicës, prof.dr. Ljiljana Shubariq, e cila tha se me përpjekje të përbashkëta janë arritur rezultatet e jashtëzakonshme në të gjitha fushat që janë vendimtare për një jetë më të mirë të qytetarëve. Sektorët prioritarë mbeten infrastruktura dhe shërbimet komunale, shëndetësia dhe politika sociale, arsimi dhe kultura.

Kryetarja e vlerësoi punën e të gjitha drejtorive komunale, veçanërisht punën me palë, ku janë pranuar mijëra kërkesa dhe është përgjigjur ndaj kërkesave në fjalë.

“Drejtoria e Buxhetit dhe Financave komunale u soll në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme ndaj çdo shpenzimi, si në buxhet ashtu edhe gjatë punës me palë përmes sporteve të arkës. Rregullimi i tregut ekonomik dhe ruajtja e interesit publik, kontrolli inspektues i subjekteve ekonomike, kontrolli dhe pezullimi i punimeve në pronën shoqërore, kontrolli i punimeve ndërtimore, parandalimi i keqpërdorimit të tokës bujqësore, përgjigja ndaj kërkesave të qytetarëve, mbrojtja e mjedisit janë vetëm disa nga aktivitetet e Drejtorisë së Inspepcionit në të cilat është punuar. Drejtoria Komunale e Arsimit, krahas mbështetjes financiare, ka ofruar mbështetje logistike për të gjitha institucionet arsimore, shtëpitë e kulturës dhe klubet sportive në territorin e komunës sonë. Ndërtuan objekte të reja, rehabilituan dhe rikonstruuan objekte ekzistuese dhe kryem punime të tjera infrastrukturore që modernizojnë dhe zgjerojnë hapësirën për procesin mësimor në institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme dhe mbështetëm të gjitha ngjarjet kulturore dhe sportive. Edhe pse pa buxhetin e vet, Drejtoria Komunale për Rini dhe Sport shënoi rezultate të dukshme. Gara të shumta sportive, turne, zgjidhje konceptuale për t'i ndihmuar klubet dhe organizatat sportive, shkollat, organizimi i fëmijëve për të shkuar në gara”, tha kryetarja Shubariq.

Shubariq shtoi se është punuar në zhvillimin ekonomik dhe se në bashkëpunim me partnerët ndërkombe tarë janë realizuar disa projekte me qëllim të fuqizimit dhe forcimit ekonomik të familjeve, individëve dhe bizneseve të vogla.

“Në Qendrën diagnostike janë ofruar mbi 50 mijë shërbime. Pothuajse të gjitha institucionet shëndetësore i kemi modernizuar me pajisje të reja mjekësore. Është ndarë një aparat për anestezi, një analizues gazi, një analizues biokimik, një aparat të ekografisë”, tha Shubariq, duke folur për shëndetësinë.

Është arritur shumë në fushën e infrastrukturës, shtoi ajo.

“Kontrata afatgjatë të rehabilitimit, mirëmbajtja e infrastrukturës dhe ndërhyrje të ndryshme, ndërtimi i objektit për banim social, ndërtimi i qendrës arsimore dhe rekreative në Graçanicë, përmirësimi i rrugës “Car Lazar” në Graçanicë, ndërtimi dhe rindërtimi i parqeve në territorin e Komunës së Graçanicës, rregullimi i oborrit dhe rrëthimi i ambulancës në Gushtericën e Poshtme dhe Uglar, renovimi i Shtëpisë për të moshuarit dhe Shtëpisë për të rinj. Është në proces të sipër ndërtimi i kapelës në varrezat e reja në Graçanicë. Një nga sukseset më të mëdha në periudhën raportuese ishte ndarja e çelësave për 34 njësi banesore në Suhadoll, me çka është zgjidhur çështja e banorëve të vendbanimit të kontejnerëve Padallishtë”, theksoi Shubariq.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, tha se para disa ditësh ka paraqitur kërkesë për deponinë e krijuar pranë rrëthrrotullimit në Graçanicë nga marketi dhe ka apeluar që të zbatohen të gjitha masat ligjore dhe të dënohet kryesi.

Kryesuesi e vlerësoi raportin që komuna e tregon ndaj arsimit dhe shkollave, sepse pa mbështetjen e komunës vetë arsimi do të ishte në telashe të mëdha. “Në emër të drejtoreve të shkollave ju falënderoj për këtë, si dhe për mbështetjen e fëmijëve tanë kur shkojnë në gara”.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 12 asamblistëve “Pro” dhe 1 votë “Kundër” të Granit Gashit miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se buxheti i Komunës së Graçanicës për vitin e ardhshëm 2025 do të jetë 9,953,348 euro dhe krahasuar me vitin 2024 është 967,889 euro më i lartë.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti nëse me këtë dokument strategjik mund të parashikohet buxheti për Drejtorinë e Rinisë dhe Sportit, si dhe Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, duke pasur parasysh se nuk kanë mjete.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se Drejtoria e Rinisë dhe Sportit për vitin 2024 ka 54,500€ për paga, 60,000€ për subvencione dhe 60,000€ për investime kapitale, ndërsa Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka vetëm 33,160€ për paga në buxhet.

Kryesuesi pyeti se kush ndikon që Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit të rritet buxheti i saj, duke pasur parasysh se në garat sportive janë arritur rezultatet e dukshme.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se menaxhmenti i komunës vendos për ndarjen e buxhetit. Pas daljes së Qarkores buxhetore 2025/1, drejtorët e drejtorive komunale dhe kabineti bëjnë propozime për buxhetin dhe në bazë të tyre ai e harton buxhetin preliminar për vitin 2025 dhe projekcionin për vitin 2026 dhe 2027.

Asamblisti Millosh Todoroviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se kush vendos nëse mjetet nga mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe shërbimet komunale mund të ridrejtohen në Drejtorinë e Rinisë dhe Sportit.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se shërbimet komunale mbulohen nga komuna nëpërmjet Administratës. Buxheti për shërbime komunale për administratën komunale është 141,000€, ndërsa për mallra dhe shërbime 1,384,200€. Mjetet prej andej mund të ridrejtohen sipas nevojës.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 13 asamblistëve "Pro", miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit për periudhën 01.12.2022-01.12.2023, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Dushan Cvejq.

Kryesuesi sugjeroi që kjo pikë të bartet në mbledhjen e radhës për shkak të gabimit administrativ.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për fillimin e procedurës së shpronësimit të tokës për zgjerimin e varrezave në Llapllasellë, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Kryesuesi shpjegoi se varrezat në Llapllasellë duhet të zgjerohen dhe se negociatat me pronarët e parcelës kanë zgjatur dy vjet dhe është arritur marrëveshja para disa muajsh. Parcelsa ndodhet pranë kishës dhe varrezave ekzistuese në mes të Llapllasellës dhe Preocit.

Asamblisti Dejan Jevtiq, para partisë “SRPSKA”, pyeti se cila është procedura për shpronësimin e tokës.

Kryesuesi u përgjigj se shpronësimi bëhet në bazë të çmimit të përcaktuar nga ministria në bazë të klasës së tokës, pas kësaj komuna vendos ndalesën për shitjen e asaj parcele, ku pastaj ajo parcelë në fakt bëhet pronë e komunës dhe pas kësaj bëhet pagesa.

**Asamblisti Granit Gashi mungon në mbledhje, të pranishëm janë 12 asamblistë dhe ka kuorum.**

Asamblisti Vlladica Qurçiq, para partisë “SRPSKA”, pyeti nëse është arritur marrëveshje me pronarin e parcelës që pas çmimit të dhënë nga ministria, pronari i parcelës të mos inicojë padi kundër komunës nëse nuk është i kënaqur me atë çmim.

Kryesuesi u përgjigj se komuna nuk mund të ndikojë tek ai nëse do ta iniciojë apo jo padi, pronari i parcelës kërkon një shumë të caktuar që është mjaft e arsyeshme, kështu që gjithçka varet nga ministria kompetente.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 12 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Inspepcionit për vitin 2023, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Inspepcionit, Marko Arsiq.

Drejtori i Drejtorisë së Inspepcionit, Marko Arsiq, tha se bëhet fjalë për raportin e paraardhësve të tij në atë pozitë dhe kërkoi nga asamblistët e pranishëm që nëse kanë ndonjë pyetje në lidhje me raportin, t'i paraqesin pyetjet me shkrim në mënyrë që të informohet në detaje.

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, tha se në një periudhë paraprake nga drejtorët e mëparshëm kanë marrë informacione se kanë pasur probleme në punën e tyre sa i përket ndërtimeve, mos respektimit të rregulloreve sa i përket mirëmbajtjes së hapësirave publike, pastaj orarit të punës së lokaleve, etj. Ajo theksoi se çdo problem ku asamblistët mund të ndihmojnë, drejtori mund të llogarisë tek ata.

Asamblisti Dejan Jevtiq, para partisë “SRPSKA”, e përgëzoj drejtorin dhe i uroi punë të suksesshme dhe veçanërisht për guximin e tij për pranimin e pozitës së drejtorit të Drejtorisë së Inspepcionit, duke marrë parasysh që të gjithë e dimë se ajo drejtori është më problematike sepse ballafaqohet me probleme të mëdha lidhur me ndërtimet pa leje.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 12 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Të ndryshme.

Asamblisti Vlladica Qurçiq, para partisë "SRPSKA", tha se në mbledhjen e kaluar kanë kërkuar që të gjitha fshatrat ta marrin simbolin kombëtare (flamurin e Serbisë), por nuk i kanë marrë.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën "Të ndryshme" të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 10:56.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami

Agron Karadollami

